**VENDIM**
**Nr. 233, datë 21.2.2008**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MJEDISEVE TË RADIOSTACIONIT TË KASHARIT NGA RADIOTELEVIZIONI PUBLIK SHQIPTAR TE MINISTRIA E FINANCAVE DHE PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI RADIOTELEVIZIONIT PUBLIK SHQIPTAR TË MJEDISEVE TË ATELIESË SË RE**

*(Ndryshuar me VKM nr. 722, datë 1.7.2009)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 10, 11,13, shkronja "c", e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e radiostacionit të Kasharit, në pronësi të Radiotelevizionit Publik Shqiptar, t'i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Financave, për t'u përdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sipas formularit dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për të përballuar shpenzimet e transferimit, të përdorë fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2008.

3. *Objekti "Atelie e re", me sipërfaqe të përgjithshme 1 213 (në mijë e dyqind e trembëdhjetë) $m^2$, në pronësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, t'i kalojë në përgjegjësi administrimi Radiotelevizionit Publik Shqiptar.*

4. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Radiotelevizioni Publik Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

| ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT<br>TË PASURIVE TË PALUAJTSHME<br>TIRANË<br><br>REGJISTRUESI<br><br>**MAJLINDA BOZGO**<br><br>*Vula* | A.IDENTIFIKIMI I PASURISË<br>ZONA KADASTRALE 2119 NR PASURISE ____ VOL ____<br>INDEKSI I HARTËS K. 3488 (230-B) ____ SHKALLA ____<br>ADRESA E PASURISË. Rrethi TIRANE ____ KATUN.<br>Rr/L ________ , P/G ____ , SP ____ , K ____<br>B. KUFIZIMET      C. PRONARI<br>V. ________<br>L. ________<br>J. ________<br>P. ________<br>D. Data: ________ , Ora ________ |
|---|---|




148/32
148/22
148/33
148/23
148/26
148/34
148/25
257/2
257/1
471
164/8

*(Shtuar me VKM nr. 722, datë 1.7.2009)*

